

STRABAG AG – DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1-2
PASQYRAT FINANCIARE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7 -24

PËRMBAJTJA

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1-2
PASQYRAT FINANCIARE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7 -24

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për drejtimin dhe aksionerët e Shoqërisë Strabag AG – Degë e Shoqërise së Huaj

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Strabag AG – Degë e Shoqërise së Huaj (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2016, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2016, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyra financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

27 mars 2017



Teit Gjini
Auditues Ligjor

 MAZARS

Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjakët",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al , info@mazars.al

STRABAG AG – DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e pozicionit financiar
më 31 dhjetor 2016**

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
AKTIVE			
Aktivët afatgjatë			
Aktivët afatgjatë materiale	6	14,784,573	18,480,717
Llogari të arkëtueshme tregtare afatgjatë	9	1,500,000	104,638,814
Totali i aktiveve afatgjatë		16,284,573	123,119,531
Aktivët afatshkurtra			
Punime në proces	7		8,246,369
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	8	223,618,317	338,863,502
Llogari të arkëtueshme tregtare	9	433,509,755	203,916,994
Llogari të arkëtueshme të tjera	10	44,495,980	38,484,830
Mjetet monetare	11	62,095,913	137,332,262
Totali i aktiveve afatshkurtra		763,719,965	726,843,957
Totali i aktiveve		780,004,538	849,963,488
KAPITALI			
Rezerva		8,979,944	8,979,944
Fitime të mbartura		82,685,596	77,222,192
Fitimi i ushtrimit		16,537,496	5,463,404
Totali i kapitalit	12	108,203,036	91,665,540
DETYRIMET			
Detyrime afatgjatë			
Llogari të pagueshme tregtare afatgjatë	13	1,500,000	92,489,719
Totali i detyrimeve afatgjatë		1,500,000	92,489,719
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	13	445,956,394	237,944,440
Detyrime tatimore	14	1,028,031	829,583
Llogari të tjera të pagueshme	15	823,846	1,088,098
Të tjera të pagueshme ndaj palëve të lidhura	16		46,727,229
Parapagime dhe të ardhura të shtyra	17	222,248,317	378,973,965
Provizione për penalitete	18	244,914	244,914
Totali i detyrimeve afatshkurtra		670,301,502	665,808,229
Totali i detyrimeve		671,801,502	758,297,948
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		780,004,538	849,963,488

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga 7 faqja deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

STRABAG AG – DEGE E SHOQËRISË SË HUAJ*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura	19	2,094,523,945	1,172,481,321
Total të ardhura		2,094,523,945	1,172,481,321
Materiale të para dhe të konsumueshme	20	(2,018,015,364)	(1,086,601,390)
Shpenzime personeli	21	(36,767,214)	(41,122,286)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	6	(3,696,144)	(14,353,750)
Shpenzime të tjera	22	(23,741,935)	(24,219,495)
Total shpenzime		(2,082,220,657)	(1,166,296,921)
Shpenzime të tjera financiare (neto)	23	7,476,227	(78,092)
Fitimi/humbja para tatimit		19,779,515	6,106,308
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	24	(3,242,019)	(642,904)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(3,242,019)	(642,904)
Fitimi/humbja e vitit		16,537,496	5,463,404
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		16,537,496	5,463,404

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

STRABAG AG – DEGE E SHOQËRISË SË HUAJ

(Merat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Rezerva	Fitim i pashpërndarë	Fitim/(humbja) e vitit	Totali
1 janar 2015	8,979,944	75,591,175	1,631,017	86,202,136
Transferim në fitime të mbartura				
Fitimi i vitit		1,631,017	(1,631,017)	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:			5,463,404	5,463,404
31 dhjetor 2015	8,979,944	77,222,192	5,463,404	91,665,540
Transferim në fitime të mbartura				
Fitimi i vitit		5,463,404	(5,463,404)	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:			16,537,496	16,537,496
31 dhjetor 2016	8,979,944	82,685,596	16,537,496	108,203,036

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga administratorët _____ dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:

Z. Martin Mayrhofer
Administrator

Z. Ilir Trebicka
Administrator

STRABAG
STRABAG AG / Branch Office
Rr. "Barshak Biba"
Old Tirana Building
Tirana / Albania
NIFR K74401601R

Kelvin Hilla

STRABAG AG – DEGË E SHOOËRISË SË HUAJ*(Vlerat janë në Lek)*

Pasqyra e rrjedhjes së parësë
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Shënime	Per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Flukset e parësë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	19,779,515	6,106,308
Axhustime për zërat jo-monetare: Zhvlerësimi dhe amortizimi	3,696,144	14,353,750
Fitim/humbje nga shitja e Aktiveve Afatgjata Materiale	-	-
	23,475,659	20,460,058
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi në inventar	8,246,369	(8,246,369)
Ndryshimi në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(20,461,931)	(622,298,643)
Ndryshimi në llogari të pagueshme dhe të tjera	(86,496,446)	714,207,718
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktiviteti i shfrytëzimit	(75,236,349)	104,122,764
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	-	-
Mjetet monetare neto nga aktiviteti i shfrytëzimit	-	-
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale	-	(20,072,481)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale	-	51,047,943
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	-	30,975,462
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkurtër		
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	-	-
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(75,236,349)	135,098,226
Mjetet monetare në fillim të periudhës	137,332,262	2,234,036
Mjetet monetare në fund të periudhës	62,095,913	137,332,262

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

STRABAG AG – DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

Strabag AG – Degë e Shoqërisë së Huaj është degë e Strabag AG LLC regjistruar në Shqipëri dhe angazhuar në aktivitetet e ndërtimit.

Adresa e regjistruar e shoqërisë është Rruga "Bardhok Biba", Old Tirana Building, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në korrik 2007 me NUIS K74401601R.

Më 31 dhjetor 2016, shoqëria ka 4 punonjës. (2015: 4).

2. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë efektive për periudhat e raportimit financiar që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2016.

- Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara", SNRF 12 "Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me interesat në njësitë e tjera ekonomike" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta" - Njësitë investuese: Aplikimi i përjashtimit të konsolidimit - miratuar nga BE-ja më 22 shtator 2016 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016)
- Ndryshimet në SNRF 11 "Marrveshjet e përbashkëta", Kontabiliteti për Blerjet e interesave në operatione të përbashkëta - të miratuar nga BE-ja më 24 nëntor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)
- Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare", Paraqitja Fillestare - miratuar nga BE-ja më 18 dhjetor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)
- Ndryshimet në SNK 16 "Aktivet Afatgjata Materiale (toka, ndertesa, makineri e pajisje)" - Sqarimi i Metodave pranueshme të Zhvlerësimi dhe Amortizimi - të miratuara nga BE-ja më 2 dhjetor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).
- Ndryshimet në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve" - Përcaktimi i planeve përfituese: Kontributet e punonjësve - të miratuara nga BE-ja më 17 dhjetor 2014 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 shkurt 2015).
- Ndryshimet në SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale" - Metoda e kapitalit neto në pasqyrat financiare të veçanta - e miratuar nga BE-ja më 18 dhjetor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)
- Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikël 2010-2012)" që rezultojnë nga projekti për përmirësimin vjetor të SNRF (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin - miratuar nga BE-ja më 17 dhjetor 2014 (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 shkurt 2015).
- Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikël 2012-2014)" që rezultojnë nga projekti për përmirësimin vjetor të SNRF (SNRF 5, SNRF 7, SNK 19 dhe SNK 34) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin - miratuar nga BE-ja më 15 dhjetor 2015 (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të kompanisë.

2. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)

2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuar

Në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet janë emtuar por nuk janë ende efektive:

- SNRF 9 "Instrumentat Financiar" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018).
- SNRF 15 "Të ardhurat nga Kontratat me Klientët" dhe amendime të mëtejshme (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018).
- SNRF 16 "Qiratë" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019).
- Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat e bazuara në aksione", Klasifikimi dhe matja e pagesës të bazuar në aksione (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018).
- Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit"- Aplikimi i SNRF 9 "Instrumentat Financiar" me SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 Janari 2018 ose kur SNRF 9 "Instrumentat Financiare aplikohet për herë të parë).
- Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta"- Shitja ose Kontributi aseteve ndërmjet një investitori dhe ortakut ose sipërmarrjet e përbashkëta dhe ndryshime të mëtejshme (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018).
- Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e Flukseve Monetare"- Paraqitja fillestare efektive për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 Janari 2017).
- Ndryshimet në SNK 12 "Tatimi mbi të ardhurat"- Njohja e detyrimeve tatimore të shtyrë për humbjet e parealizuar (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2017)
- Ndryshimet në SNK 40 "Aktivet Afatgjata Materiale të Investuara"- Transferimet e aktiveve afatgjata materiale të investuara (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018)
- Ndryshime të standardeve të ndryshme "Përmirësime të SNRF-ve (cikli 2014-2016)" që rrjedhin nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12, IAS 28) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (Ndryshimet në SNRF 12 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017 dhe ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018)
- SIC 22 "Transaksionet në monedhë të huaj dhe parapagimet" (për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018)

Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

3. Bazat e përgatitjes

3.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

3.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

STRABAG AG – DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

3. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

3.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

3.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezentuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

3.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Informacionet në lidhje me zonat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabël të cilat më së shumti ndikojnë në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare, janë paraqitur në shënimin nr. 5.

4. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në të gjitha periudhat e pasqyruara në këto pasqyra financiare dhe në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria.

4.1 Të ardhurat nga kontratat dhe fitimi

Të ardhurat nga kontratat përfshijnë vlerën totale të punës ndërtimore të kryer gjatë vitit. Fitimi nga kontratat afatgjata njihet me përqindjen e rregulluar mbi bazë të përfundimit. Asnjë fitim nuk merret deri kur një kontratë nuk ka avancuar deri në pikën ku fitimi përfundimtar i realizueshëm mund të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme. Provizionet janë krijuar për të gjitha humbjet e shkaktuara në datën e raportimit plus për çdo humbje të mëtejshme të parashikuar për sjelljen e kontratave drejt përfundimit.

4.2 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
EUR/ Lek	135.23	137.28

STRABAG AG – DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.3 Instrumenta financiare

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Aktivitet financiar çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huatë

Huate janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normën efektive.

Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes të koston së amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skanton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar, ose, kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Të tjera instrumenta financiare jo derivative janë matur me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

STRABAG AG – DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.3 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.4 Inventari

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4.5 Prodhimi në proces

Prodhimi në proces në kontratat afatgjata llogaritet me kosto plus fitimin që i atribuohet, në masën që është e arsyeshme me pas krijimi provizioneve për kontigjencat, minus ndonjë humbje të ndodhur ose të parashikuar për të sjellë kontratat drejt përfundimit dhe minus shumat e arketuara ose për të arketuar si pagesa në progres. Për këtë arsye, kostot përfshijnë të gjitha kostot direkte të kontratave, për çdo kontratë kur arketimet plus të arketueshmet tejkalojnë vlerën kontabël të punës së kryer diferenca e shtuar përfshihet në llogaritë e pagueshme dhe të shtyrat.

4.6 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të aktiveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të aktiveve afatgjata materiale dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

STRABAG AG – DEGE E SHOQËRISË SË HUAJ
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)
4.6 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivit duke zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet me normat si më poshtë në bazë të vlerës së mbetur:

Ndërtesa	5%
Mobilje dhe orendi	20%
Mjetet e transportit	20%
Pajisje kompjuterike	25%
Makineri dhe pajisje	20%

Këto norma reflektojnë më së shumti vlerën e pritshme të konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike që burojnë nga aktivet afatgjata materiale. Prodhimi në proces nuk amortizohet. Normat e amortizimit dhe vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale rivilësohen në çdo datë raportimi.

(iv) Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysht në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.7 Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

